



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 488/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK), dega në Vushtrri për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), dega në Prishtinë.

Arsyetim

Me datën 04.11. 2013, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se më datë 03.11.2013 në ora 14:01 kanë vrejtur se në Qendrën e Votimit (QV) 2713B është lejuar një person që të votoj me fotokopje te letërnjoftimit në Vushtrri, thuhet në pretendimet e ankuesit .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e parashtruesit të ankesës se në Qendrën e Votimit 2713B në Vushtrri ,është lejuar një person qe të votoj me fotokopje të letërnjoftimit nuk qëndrojnë, ngase parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar asnjë provë si dëshmi bindëse për parregullsinë e pretenduar. PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i pa argumentuar në prova relevante , andaj në kuptim te nenin 3.6 pika c) të Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it si dhe nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 488/2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*